



Prishtinë, 8 shkurt 2008

Reagim

Njëmbëdhjetë artistë kosovarë kanë qenë të ftuar të ekspozojnë veprat e tyre në galerinë “Kontekst” në Beograd. Një ndër veprat që do të ekspozoheshin atje ka qenë edhe portreti i Heroit tonë kombëtar Adem Jashari, veper e artistit Dren Maliqi.

Një lukuni serbësh historikë kanë perdhosur këtë vepër artistike, duke shqyer portretin e Heroit tonë. Aleanca Kosova e Re e dënon një vandalizëm të tillë antiqytetëruës të nacionalistëve serbë. Histeria e shpërfaqur në Beograd tregon edhe njëherë ngarkesat e pashërueshme shoveniste serbe, pre e të cilave në të kaluarën, veç tjerash, ka qenë gjithë arti dhe kultura shqiptare.

Duke i uruar për guximin artistik, Aleanca Kosova e Re, mbështet fuqishëm aktivitetin e artistëve tanë kudo që ata janë dhe veprojnë.

Aleanca Kosova e Re